



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22.04.2022,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri dhe Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina, kryesues.**

Para se të fillonin me procedimin e mbledhjes me pikat e rendit të ditës, kryesuesi njoftoi se janë propozuar për këtë mbledhje edhe dy propozime nga Drejtoria e Pronës:

- Propozimi për miratimin e Vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, lagja "Arbëria, rr. "Toni Bler" në Prishtinë dhe
- Propozimi për miratimin e përcaktimit të lokacionit, ku është planifikuar të ndërtohet objekti për varrosjen, groposjen e kafshëve të ngordhura.

Në koordinim me kryetarin, është vendosur që përveç 17 pikave të parapara për këtë mbledhje, të cilin material ua kemi përcjell, të shtohen edhe këto dy propozime, ku për shkak të numrit të madh të pikave dhe volumit të materialeve me marrëveshje me kryetarin, kemi vendosur që t'i ndajmë këto pika në dy seanca të rregullta të Kuvendit. Për mbledhjen që do të mbahet më 28.04.2022, do të jenë pikat: 2,3,4,6,12,13,15,17,18, ndërsa pikat që mbetën për seancën e radhës, që do të mbahet në kohë sa më të shkurtër, do të jenë pikat: 5,7,8,9,10,11,14,16.

**Valbona Ahmeti- Makolli** tha bëri të ditur se pika e 16-të është shumë me prioritet dhe ka afat ligjor.

**Fatos Dibra** dha sqarime për këtë pikë.

**Kryesuesi** tha se ne kemi planifikuar me i diskutuar sot në KPF 19 pikat e për mbledhjen e Kuvendit me u ndarë.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se nuk po më duket e logjikshme, sot i kemi ndarë pikat, pse me i diskutuar pikat që kanë me qenë në mbledhjen e katërt të KPF-së. Kjo pika që ka të bëjë me strehimoren e qenve endacakë është shumë e rëndësishme, gjë që më habit fakti se si e keni vlerësua që ta leni për seancën e radhës.

**Fatos Dibra** dha sqarime lidhur me pikën e 16-të, të cilën e ka kthyer Ministria.

**Nora Kelmendi** pyeti se a e kanë shikuar a është në përputhje me Planin rregullues.

**Fatos Dibra** u përgjigj se Ministria thotë se lokacionin duhet me bërë në harmoni me Planin rregullues të ky caktim i lokacionit, te aktet që i nënshtrohen ligjshmërisë, këtu thotë këto për nevoja të Komunës nuk i nënshtrohen hiq.

**Nora Kelmendi** pyeti se si veproni ju kur ua kthen Ministria kështu, a i ktheni ju përgjigje a çka?

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** tha se si pyetje ti po sugjeron apo po jep opinion që ne si Kuvend duhet me rrëzuar këtë opinionin e Ministrisë?

**Fatos Dibra** tha jo, unë fola vetëm në aspektin ligjor.

**Gëzim Sveçla** pyeti se si na kishit këshilluar neve si asamblistë me vepruar në këtë rast, po flas në aspektin ligjor.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Nora Kelmendi** pyeti Zyrën ligjore se a i kanë lexuar kushtet e fshatrave, janë të publikuara në "Google" kushtet ndërtimore për fshatra, e ke edhe për Slivovën, tregon çka mundet të ndërtohet në Slivovë.

**Fatos Dibra** u përgjigj, se flet vetëm për aspektin procedural, se për aspektin teknik e merr prej planifikimit dhe nuk fol se nuk e di.

**Gëzim Sveçla** sugjeroi përfaqësuesin e Zyrës ligjore, që të shkojë në Ministri për të pyetur se ku qëndron problemi.

**Kryesuesi** pyeti se a janë me i trajtuar të gjitha pikat në KPF, apo me i ndarë në dy mbledhje të KPF-së si për Kuvend.

**Doruntinë Maloku** tha se arsye pse nuk kanë ardhur me kohë pikat me hy në rend dite në KPF për këto dy propozime për dhënie në shfrytëzim për AUV dhe Policinë e Kosovës, është për shkak se nga Policia e Kosovës e kanë marrë si Drejtori e Pronës kërkesën më 15 prill. Pasi që dokumentet i kemi komplet, ju lus që ta merrni parasysh dhe t'i kalojmë se dy çështjet kanë urgjencë.

Sa i përket kopjes së Planit, dua t'ju jap sqarim në lokacionin ku është vendosur të jepet në shfrytëzim për Policinë e Kosovës, në lagjen "Arbëria" mungojnë ndarjet, ekziston vetëm pjesa tekstuale, nuk kemi pasur mundësi t'i bashkëngjisim në dosje Kopjen e planit për parcelat në fjalë.

Sa i përket çështjes së groposjes lënda është e kompletuar, andaj ju lus të keni mirëkuptim dhe ta përfundojmë këtë çështje.

**Nora Kelmendi** u shpreh se sa i përket ndarjeve po thoni i ka mare Serbia, ju kuptoj, është në rregull, mirëpo ju mund të dilni në terren me bërë identifikimin dhe ndarjet. Ne nuk dimë ku janë parcelat për Policinë, ne kur kemi qenë më herët në Kuvend i kemi pasur të njëjtat

probleme, si p.sh. te nënparkingu te Fakulteti i Filologjisë nuk ka pasur ndarje, e kemi rregulluar, kanë dalë gjeodetët kanë bërë identifikimin, matjet dhe ajo është rregulluar dhe i kemi ndarë parcelat. Nuk e di si mund ta votoni pa ndarje, a i dini ku janë parcelat?

E njëjta vlen edhe për Teatrin.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** pyeti se këto a iu kanë nënshtruar aktit të shqyrtimit nga Ministria, se po na i kthen se nuk janë të kompletuara prapë.

**Doruntinë Maloku** u përgjigj po, dha sqarime.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Nora Kelmendi** theksoi se shkelje është nëse nuk e dinë ku gjendet parcela, se nuk e ke pjesën grafike.

**Doruntinë Maloku** u shpreh se e dimë ne ku është parcela.

**Kryesuesi** pyeti se a janë për me i trajtuar të gjitha pikat në KPF, apo me i ndarë në dy mbledhje ashtu si për Kuvend.

**Bahri Gashi** shprehu mospajtim që pikën për strehimoren e qeneve endacakë po e shtyjnë për mbledhjen e radhës. Mendoj se ky është problemi kryesor, është gabim me e shtyrë edhe një ditë të vetme, edhe ashtu jemi vonë, ka ardhur një vendim prej Ministrisë me trajtuar atë problem e mos me shty se një ditë na kushton.

**Leutrim Retkoceri** tha se nëse thirret mbledhja tjetër në fillim të muajit maj është në rregull edhe me shty, për disa pika urgjente nëse nuk thirret është vonë, nëse thirret është në rregull.

**Kryesuesi** tha se në kohën sa ma të shkurtë unë e thirri mbledhjen tjetër të rregullt, në mënyrë që me i trajtuar pikat që po mbesin.

U arrit pajtueshmëria që me i ndarë pikat në dy mbledhje të KPF-së.

Për këtë mbledhje u caktua ky

## REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë e Financa;
2. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022;
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2022 (TM 1);
4. Raporti i punës i Komunës së Prishtinës ( 7 dhjetor 2021 - 31mars 2022 );
5. Propozimvendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta;
6. Propozimvendimi për plotësimin e ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, të datës 11.02.2022;
7. Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës, për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrjen publike lokale;

8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkionale, Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë;
9. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme-Policisë së Kosovës, lagjja "Arbëria", rr. "Toni Bler" në Prishtinë;
10. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
11. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetet për Politikë dhe Financa.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetet për Polikë e Financa.

#### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022.**

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke cekur se te bartja e mjeteve totali është 44,645,470.80 €, nga buxheti i rregullt i pashpenzuar është 34,753.744.35 €, ndërsa te tejkalimi i planit për të hyrat vetanake është 9,891,726.45 €, të hyrat vetanake janë diku 7 milion e diçka, por këtë 2 milionëshin e kanë rritur të hyrat indirekte.

Këto janë mjete që kanë mbetur, shumica prej tyre që kanë kaluar ose në ankesa ose në OSHP, që tani bëhen dy vjet, nuk ka bord edhe projektet e reja të vitit 2022 të cilat e kanë vlerën më të madhe, edhe ato komplet kanë kaluar në OSHP dhe nuk e dimë afatin kur zgjidhet, sepse është një ngërç i madh i investimeve kapitale. Ne si qeveri komunale kemi kërkuar dhe jemi takuar sa here në zyrën e KRPP-së kemi kërkuar sqarime se kemi telashe të mëdha me OSHP. Sipas tyre, duhet Kuvendi i Kosovës me ua dhënë një opinion publik lidhur me këto ngërçe që janë.

Po ashtu, një problem është edhe rritja e çmimeve, e sidomos në ndërtimtari. Këto kanë penguar shumë te kjo bartja e mjeteve, që i kemi diku 80-85% e kompanive. Kemi pasur takim, janë për me u tërhequr vetëm për arsye të çmimeve, ne nuk jemi të interesuar me u tërhequr. Ne kemi qenë edhe në Ministrin e Financave, jemi takuar me zotëri Muratin edhe ai është në dijeni se të njëjtin problem e ka edhe Ministria e Infrastrukturës.

Po shpresojmë se Kuvendi i Kosovës ka me dhënë një opinion që me dalë prej këtij ngërçi.

**Fatos Dibra** dha sqarime lidhur me problemet e prokurimit.

**Mimoza Sylejmani** theksoi se Komuna në OSHP i ka më shumë se 17 milionë.

**Nora Kelmendi** kërkoi të dijë se a kanë bërë kërkesë këto kompanitë që e keni rritur çmimin për 10-20 % disa prej tyre.

**Valbona Ahmeti - Makolli** u përgjigj jo, sepse ato janë me marrëveshje të kontratës, secila kontratë që është nënshkruar më herët, janë të publikuara, disa kontrata kanë 10 -20% si punë shtesë dhe disa janë 30%.

**Nora Kelmendi** theksoi se në disa kontrata që keni bërë disa bartje keni bërë, vetëm disa mjete barten, sigurisht bartjet tjera i keni lënë vitin e ardhshëm.

**Valbona Ahmeti - Makolli** u përgjigj se diku 70% janë të vitit 2022.

**Nora Kelmendi** tha se janë edhe disa kontrata, p.sh. i keni bërë disa bartje që e kanë vlerën më të madhe se vlera e kontratës.

**Valbona Ahmeti - Makolli** u përgjigj se është rasti i dy shkollave, ato janë nga viti 2015, këto i rregullojmë dhe i dorëzojmë këto vërejtje.

**Nora Kelmendi** pyeti se a mundemi me na shkruar në komente për këto çështje që kanë ndodhur.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se gjithsesi këto ndryshime janë vetëm te investimet kapitale, e shtoj edhe një rubrikë.

**Nora Kelmendi** tha se sa i përket këtij 1 milionit që i kishit ndarë për mallra dhe shërbime, e njëjta është, disa i kemi me mbetje disa pa mbetje, dhe subvencioneve kishte qenë mirë me ua qitur komentet.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime.

**Nora Kelmendi** tha edhe për gjykatë, për kthimin e zyrtarëve për kompensim të pagave kishte qenë mirë të na jepni ndonjë komente, arsyetimi se cilët zyrtarë janë kthyer, çfarë kompensim duhet bërë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke thënë se ka njerëz që nuk kanë ekspertizë ligjore, ato që nuk janë me ekspertizë unë nuk kam mundur me i llogaritur, ata që kanë ekspertizë, që është në rregull, ne me këto mjete mundemi me i mbuluar, mirëpo listën mundem me ua dërguar për ata që kanë ekspertizë.

**Jeta Rafuna** tha se në dokument i kam parë bartjen edhe transferet, dhe te investimet kapitale 26 milionë dhe besoj që gjatë këtij viti do të përfundojnë shumë projekte që kanë filluar para shumë viteve. Këtu te OSHP-ja, ju kisha thënë formojeni atë bord dhe të zhbllkohemi.

**Leutrim Retkoceri** tha se kishte me qenë mirë me kërkuar politikisht ndoshta secili anëtar, që OSHP-ja me hapur rrugë për krejt këto projektet se, në të kundërtën, edhe viti i ardhshëm ka me na përcjellë me të njëjtën gjendje.

**Bahri Gashi** u shpreh se unë jam ai që kam kontrata me institucione, jam pjesë e kontratave, ne jemi krejt duke u tërhequr prej këtyre kontratave, çmimet janë të tmerrshme, dëmet janë shumë të mëdha jo vetëm në Prishtinë, por në tërë Kosovën, të gjitha këto kontrata kanë me rënë.

Shpresoj që vitin e ardhshëm nuk e bëjmë këtë bartje, përmirësohet Ligji i prokurimit, që është primar, pastaj është edhe OSHP-ja, por Ligji i prokurimit është parësor.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022 dhe dërgohen në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2022 (TM 1).**

**Valbona Ahmeti - Makolli** theksoi se materialin e keni marrë, është dashtë të qiten shifrat siç janë, përndryshe deri më 13 shkurt nuk ka punuar sistemi hiq, janari ka qenë i papunuar, ka pagesa që nuk janë paguar por që duhet me pritur bartjen, nuk janë projekte të kryera, kemi rënie të të hyrave. Në këta tre muaj kemi 30% rënie të të hyrave prej tatimit në pronë, d.m.th. kjo është kryesorja, po shpresoj tash në këtë periudhë veç fillon puna dhe rriten të hyrat. Te pagat dhe mëditjet kemi një zvogëlim, sepse vitin e kaluar ka qenë me i paguar ekstra, pra punë shtesë punëtorët e shëndetësisë, shpenzimet e investimeve kapitale janë shumë pak, te shpenzimet e komunalive kam kërkuar me i bartur 400 mijë se shkojnë.

**Mirsad Vitia** tha se drejtoresha ishte e qartë, por komentet e mija do t'i jap në Kuvend.

**Jeta Rafuna** tha se edhe unë komentet e mia do t'i jap në Kuvend.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se kam vërejtur që ka dukshëm rënie të të hyrave komuna. Gjithmonë TM 1 ka qenë më i ulët, në të gjitha raportet, por shpresoj në tremujorët e tjerë nuk ka me vazhduar kështu, sepse mundet me qenë problem edhe për buxhetin, kështu që duhet me shikuar ose me rishikim të buxhetit, ose me buxhetin e ri me shikuar çka munden me qenë masat që duhet ndërmarrë për të pasur më shumë grumbullim të mjeteve. Po ashtu, tha se vonë e ka pasur informacionin se më 13 shkurt, është hap thesari për ekzekutimin e pagesave. Mendoj se kjo i ka rezultuar drejtpërdrejt në një performancë jo të mirë të raportit financiar, sepse në të gjitha drejtoritë shpenzimet janë tepër të ulëta për shkak të kësaj dhe mendojë kjo është shkaktare.

**Valbona Makolli - Ahmeti** dha sqarime.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se logjikisht kjo ka sens nëse njerëzve u hiqet tatimi në pronë si kushtëzim për regjistrimin e veturave, për shkak të kohës së pandemisë, me përfundon e pandemisë duhet prapë të rikthehet se nuk funksion ndryshe.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se duhet gjetur forma të tjera për të inkasuar tatimin në pronë.

**Valbona Makolli - Ahmeti** tha se duhet bërë me procedura përmbarimore.

**Fatos Dibra** shprehu mendimin se duhet nisur një procedurë prokurimi, me angazhuar përmbarues, që këto borxhe me i vjelë me përmbarues, sepse nuk kemi mundësi tjetër.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se nëse është mundësia e vetme me përmbarues, unë mendoj se është mundësia më e keqe e mundshme.

**Gëzim Sveçla** ths se kur filloni me përmbarues, filloni prej borxhlinjve më të lartë, që kanë 40-50 mijë euro borxhe e duke vazhduar me borxhe më të vogla.

**Valbona Makolli Ahmeti** tha sqarime.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se ne duhet shikuar si komunë çka mundemi, këta që kanë biznese me i sanksionuar që kanë borxhe tatimore nëse fillojmë me përmbarues, si Komunë duhet me pasur si kriter me shkuar prej borxhlinjve të lartë e teposhtë.

**Valbona Makolli - Ahmeti** tha se i ka listat prej borxhlinjve më të mëdhenj e tutje.

**Nora Kelmendi** tha se atyre borxhlinjve të mëdhenj nuk iu kisha lejuar leje ndërtimi, ata janë biznesmenë të mëdhenj, kush paguan tatimin ju kisha lejuar leje ndërtimi.

**Fatos Dibra** tha me ju marrë me përmbarues, por jo me bërë kushtëzim, se logjika është jo me kushtëzim me ua marrë paratë.

**Bahri Gashi** shprehu mendimin se përmbarimit duhet ikur, duhet shikuar mënyra të tjera për arkëtim të borxheve.

Njëherësh pyeti drejtoreshën e Financave se a ka ndikuar edhe kjo procedura që tani me Ligj mbi 100 € nuk mundesh me ble pa tri oferta, pa procedurë të hapur, a ka mundur me ndikuar edhe kjo, se shumë drejtori kanë kryer më lehtë punë me tri oferta, shpejt e shpejt, e tash deri në 100 € është, kjo ka me ulë edhe ma shumë.

**Valbona Makolli - Ahmeti** dha sqarime.

**Bahri Gashi** në momentin që caktohen kritere, dikush ka me u dëmtuar, sa të kemi mundësi me i ikur përmbaruesit, ndoshta nuk kemi rrugë tjetër, por me i ikur mirë kishte me qenë.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a ka shumë kamata, a duhet këtu Ministria me marrë vendim me bërë fushatë 5-6 muaj, ka qenë një herë fushatë me i falur kamatat kush e paguan tatimin, ndoshta kjo kishte me qenë mënyrë më e lehtë e inkasimit.

**Valbona Makolli - Ahmeti** tha se kjo ka qenë vetëm në kohën që ka qenë pandemia, që ishim në krizë, por unë kisha propozuar, se edhe tani është njëfarë krize pandemike, me rritje enorme çmimesh.

**Bahri Gashi** shprehu mendimin se më mirë është me i anuluar të gjitha kontratat niveli qendror, dhe me filluar më herët me bërë punë më shumë, se kur Qeveria dhe Komuna të lëshojnë shumë kontrata, marrim të gjithë dhe fillojmë mos me u ankuar, sepse të gjithë jemi duke marrë punë, dhe kështu një vit kishte shkuar mirë dhe nuk do të kishte ankesa dhe të gjitha kompanitë kishin fituar nga pak.

**Kryesuesi konstatoi se u miratuan Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2022 (TM 1)dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërt**

**Raporti i punës i Komunës së Prishtinës ( 7 dhjetor 2021 - 31 mars 2022 ).**

**Leutrim Retkoceri** ceku se në mandatin e kaluar kryetari i Komunës nuk ka pasur Raport tremujor. Fillimisht unë po e shoh si punë të mirë, dëshiroj të vazhdoj deri në fund se shumë mirë është kjo.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i punës i Komunës së Prishtinës ( 7 dhjetor 2021 - 31 mars 2022 )dhe dërgohet në Kuvend.**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta.**

**Valbona Makolli - Ahmeti** tha se në buxhetin e vitit 2022 janë ndarë 60 mijë € për Shoqatat e dala nga lufta. Ju e dini se nuk kemi të drejt me u ndarë shoqatave, por vetëm me aprovim të shumicës së votës në Kuvend. Iu kanë nda tri shoqatave të dala nga lufta: Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së , Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dhe Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në mënyrë të njëjtë, mirëpo në vendim kam kërkuar deri në shtator të vitit 2022 duhet me e sjellë një raport normativ dhe një raport financiar për këto mjete që janë para publike, që janë ndarë në mënyrë direkte dhe për ata kërkohet edhe një herë një miratim nga Kuvendi komunal, edhe pse janë në buxhet, nëse nuk i sjellin raportet e hupin të drejtën me kërkuar subvencione.

**Leutrim Retkoceri** bëri të ditur se propozimi në atë kohë ka qenë propozim i GP-së së PDK-së që me iu ndarë 60 mijë € për tri shoqatat, me arsyetimin që dalin mjetet në llogari të shoqatës kryesore, pastaj shpërndahet çdo gjë që ka qenë e hapur transparente, janë edhe numrat e xhirollogarive, ua kanë kërkuar edhe raportet, po mendoj se është mirë të bëhet se për herë të parë një linjë buxhetore i dedikohet kategorisë të dal nga lufta.

Edhe disa çështje që kanë të bëjnë sidomos me organizimin e Ditës së Dëshmorëve, Epopeja e UÇK-së, kështu që ata me na ftuar neve në organizime, sepse ne i ftojm një organizim, por ata kanë organizime të shumta dhe të shpeshta. Unë kërkoj që në seancën që vjen me mbështetur këtë çështje, ka kaluar si vijë buxhetore dhe mendoj se është një punë e mirë që po bëhet.

**Gëzim Sveçla** u shpreh i patimit me z. Retkoceri, me shkuar në organizime të tilla të OJQ -ve, por mendoj se kjo është pjesë e institucionit, jo me ua lënë shoqatave.

**Bahri Gashi** ceku se duhet në Vendim me përfshirë sqarimin se mundet me qenë problem kujt ia dhe paratë se organizatat e luftës, shoqatat nuk kanë të drejt në nivel lokal me pasur llogari, kanë të drejt vetëm niveli qendror, ti ke me ia kaluar mjete nivelit qendror në nivel të Kosovës



dhe ajo ka me ia kaluar shoqatave të Invalidëve, Shoqatës së Familjeve të dëshmorëve dhe Shoqatës së Veteranëve.

**Valbona Makolli - Ahmeti** dha sqarime.

**Bahri Gashi** tha se Vendimi te neni 2 të plotësohet, të jetë Dega në Prishtinë, në të tri shoqatat.

**Gëzim Sveçla** tha Organizata e Invalidëve të Luftës është në nivel të Kosovës, duhet me shikuar a kemi të drejtë taksat e Prishtinës me i shpërndarë në nivel të Kosovës, këta nuk mundën mu bë OJQ të ndara nga Shoqata, këta janë Dega Prishtinë, tani si e kanë të rregulluar këtë pjesën e transaksioneve.

**Bahri Gashi** tha se OVL deri vonë e ka pasur një xhirrollogari që kanë marrë mjete prej Qeverisë, që kanë pasur mundësi me i shpërndar nëpër komunat që i kanë ndarë në bazë të projekteve ose financimeve nuk kanë pasur llogari lokale, nëse janë hapur qenka bërë shumë mirë. Për këtë po them drejtoreshë shiko a janë lokale, se nëse janë lokale vinë tre letërnjoftime, se OJQ -të themelohen me tre themelues, duhet me ardhur me tre.

**Leutrim Retkoceri** dha sqarime dhe u pajtua që në vendim duhet me u specifikuar Dega në Prishtinë.

**Bahri Gashi** tha se akademitë duhet me i organizuar Komuna, se shoqatat e Invalidëve, Familjeve të Dëshmorëve dhe Veteranëve nuk kanë najfarë financimi që kanë rrogë, andaj po mendoj me i marrë përgjegjësinë e sponzorimit, Komuna me u letësuara atyre, akademinë me marrë Komuna.

**Gëzim Sveçla** kërkoi që vetëm mos të vëhen në lajthitje, dhe u shpreh që parimisht e mbështesim, janë ndarë mjetet krejt në rregull është, vetëm mos të vëhemi në lajthitje me votuar diçka që pastaj paraqet problem më tutje. Nëse dalin mjetet, duhet të dalin në llogari të Shoqatës dhe gjirologaria me qenë në subjektin bartës, jo niveli qëndror, të jetë proceduralisht në rregull, të mos bëhet problematike kjo çështje.

**Valbona Makolli - Ahmeti** tha se po mbetet që të ndryshohet ky vndim, të shtohet "Dega në Prishtinë", por para se me ndryshuar, prapë po i shqyrtoj këto dokumente, nëse është nevoja i thirri përfaqësuesit dhe shikojmë.

**Osman Bllaca** sugjeroi që të sqrohet se ky vendim ka ardhur përmes Kuvendit, pasi që po mundësohet prej Rregullores, për arsye se është vetëm 2% e shumës totale që i ka rënë, vetëm nga 1200 € kemi pasur të drejtë me ua dhënë, dhe kur të jepet një subvencion, varësisht a jepet prej thirrjeve apo përmes Kuvendit, zbatohet Rregullorja që është për ndarje të subvencioneve dhe aty parashihet miratimi.

**Bahri Gashi** tha se ata njerëz invalidë kanë edhe një problem të madh të financimit të vetes për me shkuar në shoqatë, me i pritur kërkesat e njerëzve të shoqatës, ai financohet me rrogën e vetë, andaj a ka ndonjë mundësi me i ndihmuar.

**Valbona Makolli - Ahmeti** dha sqarime.

**Milazim Vitija** u shpreh se është e vërtetë që PDK -ja e ka marrë iniciativën, por të gjithë në mandatin e kaluar e kemi votuar, është shumë e logjikshme që Shoqatat e dala nga lufta e kemi obligim me i përkrahur dhe me i ndihmuar. Shumë mirë që ua kanë ndarë shumat e njejtë te trijave, e kemi votuar dhe prapë do ta votojmë.

**Kryesuesi** u shpreh i pajtimit me diskutimin e z. Vitija.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, të datës 11.02.2022.**

**Bahri Gashi** kërkoi sqarim për këtë pikë.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësimin e ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, të datës 11.02.2022 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës, për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrjen publike lokale.**

**Nora Kelmendi** shtroi pyetje për Zyrën ligjore, duke thënë se në vitin 2019 kjo është miratuar, tani i jepni autorizimin kryetarit të ri, apo?

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke thënë se ka qenë legjislaturë tjetër, i ka dhënë autorizim kryetarit të kaluar e tani i jepet kryetarit të ri autorizimi.

**Gëzim Sveçla** pyeti se ligjrishtë a duhet të lëshohet autorizimi?

**Fatos Dibra** tha po, edhe në parim autorizimi është diçka që iu ka dhënë me kryer një punë të caktuar.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës, për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrjen publike lokale, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkionale, Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë.**

**Mimoza Sylejmani** dha sqarime se pas takimeve që ka pasur ministri me kryetarin, ka vendosur për ndërrim të lokacionit. Në vitin 2004, Kuvendi i Komunës së Prishtinës e ka marrë një Vendim, që të caktohet lokacion te Fakulteti Teknik, ku nuk është ndërmarr asnjë veprim, andaj në bazë të takimeve të shumta që i kemi pasur dhe kërkimit të lokacionit, si përfundim kemi ardhur që caktimi i lokacionit të bëhet mbrapa Pallatit të Rinisë, kur të miratohet në Kuvendin e Komunës sa më shpejt që është e mundshme, Ministria do të hap një konkurs ndërkombëtar ose vendor të projektimit dhe aty do të bëhet teatri i Operës dhe Baletit, dokumentet ua kam dërguar përmes Zyrës së Kuvendit.

**Nora Kelmendi** tha se dokumentet nuk janë në rregull. Së pari, certifikatat e pronës për herën e dytë i keni dërguar, i keni dërguar vetëm faqen e parë, ku nuk shihet pronari.

**Mimoza Sylejmani** tha se sot i ka sjellë origjinalet.

**Nora Kelmendi** theksoi se në këto parcela nuk ka ndarje parcele, në Vendim shkruan nuk ka ndarje, e kur e shikon pjesën tekstuale ka ndarje. Po ashtu, e keni dërguar skicën e lokacionit, por pa kopje të planit, nuk e di si keni me vepruar?! As kushtet e ndërtimit e as leja e ndërtimit nuk munden me u lëshuar pa koje të planit.

**Mimoza Sylejmani** tha se iu ka drejtuar drejtorit të Kadastrit dhe iu ka përgjigjur me këto certifikata dhe ndarje nuk ka.

**Fatos Dibra** dha sqarime.

**Bahri Gashi** kërkoi më shumë informata, shumë dokumente erdhën tani, nuk kemi mundësi me i lexuar tani për tani. Pra në të ardhmen me na sjellë materialet komplet, që ne me qenë dakord dhe me ju përkrahur për gjithçka. Unë jam dakord për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkionale, Teatrit të Operës dhe Baletit dhe do ta votoj.

**Kryesuesi** tha se ke të drejtë, krejt keni të drejtë, vetëm te kopjet e planit nuk keni të drejtë, e din edhe drejtoresha që mungojnë por zgjidhje ka.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunkionale, Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, lagja "Arbëria", rr. "Toni Bler" në Prishtinë.**

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, lagja "Arbëria", rr. "Toni Bler", në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

*Mbledhja përfundoi në orën 12 :00.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

*Reh / J*  
Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina

